

## PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje tapet bari”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 03121000-5/Produkte kopshtarie.**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1,720,833 (një milion e shtatëqind e njëzet mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) lekë, pa Tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, ”Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenin 26 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren 34 416.66 (tridhjetë e katermije e katërqind e gjashtembedhjete pike gjashtedhjete e gjashte) lekë të lëshuar në formën e garancisë bankare ose nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. 3. Në dokumentet e tenderit

*duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”.*

## **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.1.1** - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 9001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

**2.1.2** - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 14001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

**2.1.3** - Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë **Certifikatë ISO 45001-2018** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë. (Ne rastet e bashkimit të operatoreve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO sipas zërave që ka marrë përsipër në kontratën e bashkëpunimit.)

**Argumentimi:** Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të konfirmuara pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik

është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "c" të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrushëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

**2.2.2** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për një periudhë për vitet financiare (2021, 2022,2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të vlerës së perlllogaritur të kontratës që prokurohet. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

**Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti jonë kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiro në fushën e tregëtimit të mallrave, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.**

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e thjeshtuar–Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare", nenit 42, pika 3 "Kontrata për punë/mall/shërbim e ndarë në lote" dhe neni 11, pika 1 "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

" Neni 43

*Kërkesat për kapacitetet ekonomik-financiare*

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, ne procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

Neni 11

*Kufijtë monetarë*

Në përputhje me nenin 33, të LPP-së, kufijtë monetarë janë:

a) Kufiri i lartë monetar:

- 650 000 000 (gjashhtëqind e pesëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 40 000 000 (dyzet milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

b) Kufiri i ulët monetar:

- 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë për kontratat e punëve publike;
- 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.

Të njëjtët kufij monetarë zbatohen edhe për kontratat sektoriale".

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të e Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 “Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime” ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet në maj të vitin 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

**Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.**

**2.2.3** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim/e për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga pushteti vendor për vitin 2023 sipas afateve të maturuara/përcaktuara dhe parashikuara në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar prej njësive të vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron dhe ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin/et e lëshuar nga njësia/të e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

Enti /Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e informacionit te paraqitur ne procedure e prokurimit.Ne rast injformacioni te pasakte do te veprohet konform parashikimeve te ligjit Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP, nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar.*

*Ky kriter shërben për të garantuar AK se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, kanë kapacitetet e duhura ekonomike dhe financiare si dhe janë të përshtatshëm për të kryer veprimtari profesionale.*

*Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2023 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.*

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1** . Dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, me objektin e prokurimit të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates me vlerë jo më të vogël se 20% të

vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe konkretisht: **344.166 (treqind e dyzet e katërmijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë)** lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrate ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë duke paraqitur faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4,germa (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlllogaritur të fondit limit për këtë lot. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

**2.3.2** Operatori ekonomik ofertues të ketë pjesë të stafit të paktën 1 (një) agronom të lartë, të vërtetuar me diplomë, kontratë pune (të vlefshme), librezën e punës si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të lëshuara nga administrata tatimore sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës.

*Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, për kriterin përcaktuar sipas pikës 2.3.2, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 ”Per prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat

*profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim."*

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e tapetit natyral te barit e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe në rastin konkret duhet të kenë dhe punonjës agronom, kriter që vërteton se subjekti ka stafin e duhur me qëllim garantimin e cilësisë së produktit që kërkohet nga autoriteti kontraktor.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/b "Kontrata e mallrave" të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose"*

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohet që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar punonjës që janë të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit.

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë staf teknik minimumi 10 (dhjetë) punëtorë të vertetuar me, kontratë pune (të vlefshme), librezën e punës si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të lëshuara nga administrata tatimore sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit nga data e hapjes së procedurës.

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 2, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Per prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

*" 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat*

*profesionalë ose tregtarë. Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.”*

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse objekti i prokurimit është blerja e farës së barit (material mbjellës bimor) e shohim të nevojshme të përcaktojmë këtë kriter kualifikues, pasi operatorët ekonomik ofertues që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të produkteve të sipërpërmendura duhet të kenë aftësinë teknike dhe profesionale për realizimin e kontratës objekt prokurimi dhe në rastin konkret mbase në këtë procedurë prokurimi është kërkuar që operatori ekonomik të marrë përsipër furnizimin dhe vendosjen e tapetit të barit është konsideruar e nevojshme që operatorët ekonomikë të disponojnë stafin e duhur me qëllim garantimin e cilësisë së produktit që kërkohej nga autoriteti kontraktor.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit ”Procedure e Hapur e Thjeshtuar – Mallra” ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 40, pika 5/b ”Kontrata e mallrave” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*”5. Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose”.*

Nga sa përcaktohet dhe më sipër kriteri kualifikues i sipër përmendur është në përputhje dhe me parashikimet e nenit 40, pika 5/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku parashikohet që në rastin e procedurave të prokurimit të mallrave mund të kërkohej që operatorët ekonomikë ofertues të kenë të punësuar punonjës që janë të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit.

**2.3.4** Operatori ekonomik ofertues për tapetin e barit që do të vendoset në rastin kur nuk është prodhues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit.

Në të gjitha rastet operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën **ISO 9001-2015** ose ekuivalentin, lidhur me sistemet e menaxhimit të cilësisë, të prodhuesit e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Kjo certifikatë të jetë e lëshuar nga një organi i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

**Argumentim:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe bazuar në nenin 41, pika 6, nenin 44, pika 1 të VKM-së Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik zotëron kapacitetin e nevojshëm teknik dhe plotëson termat e referencës dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor për zbatimin me korrektësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, vlerësohet e nevojshme që operatorët ekonomikë të paraqesin autorizim nga*



*prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë me mallin e nevojshëm për realizimin e kësaj procedure prokurimi. Nisur nga fakti që tapeti i barit duhet të ketë cilësi shumë të mirë dhe prodhim me çmim të ulët të rezistojë sa më mirë kushteve atmosferike, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tij është i domosdoshëm.*

*Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga shërbimet që parashikohen të realizohen si dhe për shkak të garantimit dhe rritjes së sigurisë në objekte duhet që tapeti i barit që do të vendoset të jetë sipas standarteve më të mira dhe njëkohësisht të sigurohet autoriteti kontraktor që OE fitues potencial ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke vënë në dispozicion të realizimit të shërbimit brenda kohës së përcaktuar vetëm mallra origjinale dhe me garanci. Plotësimi i kërkesës më sipër garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.*

**2.3.5** Operatori ekonomik duhet të paraqesë vetdeklarimin sipas shtojces 8 "Formulari përmbledhës i vetdeklarimit", ku të deklarojë se disponon në pronësi ose me qera kundrejt kontratës përkatëse të noterizuar, mjet transporti, si më poshtë:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Kamion me kapacitet mbajtës jo më pak se 3 ton	1 copë	Pronësi ose qera
Kamion me kapacitet mbajtës 1-1.5 ton i paisur me vinc	1 copë	Pronësi ose qera

*Për mjetet duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, Certifikaten e pronësive dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme), dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit, (te vlefshme), Certifikatën e pronësive, Certifikatë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit, duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse noteriale të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të mjetit ku të dallohet qartë targa.*

Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me mjetet që disponon sipas formatit të mëposhtëm:

Tab.1

Nr	Lloji i mjetit	Targa	Kapaciteti mbajtës	Statusi
1.				Pronësi/Qera/Përdorim

**Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit si dhe plotësimin të tabelës 1. Dokumentacioni provues do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik**

*i klasifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit*)

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së ciles pranon verifikimin e mjeteve dhe paisjeve të deklaruara 2.3.5 në cdo kohë deri në përfundim të kontratës.

c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së ciles deklaron se mjetet dhe paisjet e deklaruara sipas pikës 2.3.5 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruara në procedura të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.

ç) Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me qëllim verifikimin nga Autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/c dhe 4, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" në të cilin përcaktohet se:

*"1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

*a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*

*b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*

*c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."*

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedure e Hapure Thjeshtuar–Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 5/ç "Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

*"5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*

*ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit."*

Meqënëse parashikimet e nenit 40 pika 5/ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcakton se operatorët ekonomikë ofertues në rastin e kontratave të prokurimit të llojit "mallra" duhet të kenë në dispozicion apo vihen në dispozicion mjetet dhe paisjet e nevojshme për realizimin e furnizimit të mallrave objekt prokurimi dhe në rastin konkret të automjetetit për transportin e mallit objekt prokurimi, por pa përcaktuar se si disponohen këto automjete dhe meqënëse këto mjete qarkullojnë në territorin shqiptar, ju referuam nenit 81, 83 e 178 të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

*Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët duhet të ofrojnë furnizimin me karburant për mjetet e transportit nëpërmjet kartave elektronike të personalizuar, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, sipas kuadrit rregullator të përcaktuar në VKM nr.561, datë 29.07.2016 “Për standartizimin dhe disiplinimin e shpenzimeve të karburantit në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”. Nëpërmjet këtij kriteri synohet gjithashtu, edhe evitimi i kostove të shtuara për Autoritetin Kontraktor, sa i përket kostos së prodhimit dhe pajisjes me karta elektronike të personalizuar, në funksion të zbatimit të kontratës.*

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë ku merr përsipër furnizimin, plehërimin paraprak me humus pylli si dhe vendosjen e tapetit të barit në objektet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor.

***Argumentimi:** Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Për këtë qëllim është kërkuar që të paraqitet një deklaratë e Operatorëve Ekonomikë ofertues, të cilët duhet të ofrojnë furnizimin dhe vendosjen e mallit objekt prokurimi ne destinacionet e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, gjë e cila garanton Autoritetin Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës, sipas kuadrit rregullator të përcaktuar”. Nëpërmjet këtij kriteri synohet gjithashtu, edhe evitimi i kostove të shtuara për Autoritetin Kontraktor, sa i përket furnizimit dhe vendosjes, në funksion të zbatimit të kontratës.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikullin e kërkuar vazo lulesh, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Termat e referencës dhe kërkesat funksionale/ specifikimet teknike janë hartuar nga struktura të specializuara/ Grup pune për objektin që prokurohet, i ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike/ termave të referencave, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”(I ndryshuar), për përmbushjen e qëllimit dhe rezultateve që pritet të arrihen nga Autoriteti Kontraktor, si më poshtë:

**Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse bashkëlidhur dokumentave standarte të tenderit, për procedurën me objekt: Blerje tapet bari**

Specifikimi i Materialeve:

- **Tapet bari**

1. Të jetë mbi 2 vjeçar .
2. Të jetë i llojit Festuca arundinaceae
3. Të jetë me rrjetë brenda.
4. Të ketë trashësi prerje 3 cm.

**Shënim:**

a)Për shkak të temperaturave të larta që ka Tirana malli do të lëvrohet sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor

b) Operatori Ekonomik duhet të marrë përsipër furnizimin dhe vendosjen e tapetit të barit objekt prokurimi ku do te perfshihet dhe procesi i plehërimit me humus sipas normave teknike në mënyrë që vendosja e tapetit te mos ketë problematika me tharjen përpara shtrimit të tapetit.

*Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*